**VENDIM**
**Nr. 129, datë 22.2.2017**

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE NË TURIZËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 31, të ligjit nr.93/2015, "Për turizmin", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për turizmin, si më poshtë vijon:
- Sekretari i Përgjithshëm, kryetar;
- Drejtori i Përgjithshëm i Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimit, anëtar;
- Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit, anëtar;
- Drejtori i Financës, anëtar;

- Drejtori i Politikave dhe Planifikimit të Turizmit, anëtar.

2. Caktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, përfaqësues të shoqatave në sektorin e turizmit, si më poshtë vijon:
- Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA), anëtar;
- Shoqata e Guidave Shqiptare, anëtar.

3. Vendimi nr.280, datë 13.4.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**